



Prishtinë: 16.05.2014

Kodi i ZRRE-së: V_629_2014

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L-185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1084_01_14**;
- Ankesa e KEDS-it e datës 28.04.2014.

në seancën e mbajtur më datë 16 maj 2014, nxorri këtë:

V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e KEDS-it ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin V. I. me shifër të konsumatorit: DPR – 90047960) nga Prishtina ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_1114_04_14 i datës 03.04.2014.

Arsyetim

Departamenti i Faturimit në KEDS me datë 04.06.2013 i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike për muajin maj 2013 në vlerë financiare 58.28€, si dhe me datë 04.07.2013 faturën mujore të energjisë elektrike për muajin qershor 2013 në vlerë financiare 52.63€.

Me datë 08.07.2013 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për konsumator në KEDS duke kundërshtuar faturën e muajit maj dhe qershor 2013 për shkak të leximit dhe faturimit jo të saktë.

Me datë 17.07.2013 Departamenti për Konsumator në KKDFE iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e tij bazuar në rrjedhën e energjisë elektrike dhe listave të leximit të KKDFE-së për muajin maj dhe qershor 2013.

Konsumatori pas marrjes së përgjigjes së KEK-ut me datë 07.08.2013 ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE duke bërë kontestimin e faturave të energjisë elektrike për muajin maj dhe qershor të vitit 2013 për shkak të leximit dhe faturimit jo të saktë nga ana e KEDS. DMK pas parashtrimit të ankesës së konsumatorit ka bërë shqyrtimin e ankesës dhe me datë 03.04.2014 ka nxjerr vendim duke e **aprovuar** ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KEDS që të: 1) Korrigjon faturat nr. 05130DPR-90047960 të datës 04.06.2014, nr. 06130DPR-90047960 të datës 04.07.2013 dhe nr. 07130DPR-90047960 të datës 04.08.2013 në shifrën DPR – 90047960, duke bërë shpërndarjen proporcionale të shpenzimit të energjisë elektrike për periudhën tre mujore prej muajit 05/2013 deri më 07/2013 dhe atë në vlerë **(-84.17€)**.



Baza e kundërshtimeve të KEDS-it të theksuara në ankesë është se DMK e ZRRE-së, gabimisht ka bërë vlerësimin e provave dhe shkresave të prezantuara të lëndës për faktin se në bazë të shënimeve që disponon KEDS-i, për matje të kontestuar për muajt 5, 6 dhe 7 të vitit 2013 konsumatorin e ka ngarkuar sipas sistemit një tarifor, sistem i aprovuar nga vetë ZRRE. Pika e dytë e kundërshtimit është për faktin se KEDS-i është i obliguar që konsumatorin ta lexoj me rregull dhe njëherit t'ia dorëzoj edhe faturën, çka me rastin konkret është vepruar drejt. Në ankesë theksohet se edhe për periudhën 8 – 2012 deri 3 – 2014, proporcioni i shpenzimit të konsumatorit është 11 me 89% ku në muajin maj, qershor dhe korrik 2013 është faturuar me çmim një tarifor sipas gjendjes së shpenzimit në njehsor. KEDS në ankesë thekson se bazuar në këtë nuk ka asnjë argument të vlefshëm mbi të cilën bazë duhet të shkarkohet konsumatori nga faturat e lartcekura, arsyetimet e konsumatorit në ankesë kanë qenë të pabazuara dhe të bëra me qëllim që ti shmangen përgjegjësisë.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 16 maj 2014 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e KEDS-it, përkatësisht bazën e kundërshtimit dhe pas vlerësimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës ka vlerësuar se argumentet e prezantuara nga ana e KEDS nuk janë bindëse për faktin se me asnjë provë nuk ka argumentuar se DMK ka bërë gabimisht vlerësimin e provave gjatë vendosjes së kësaj çështje. Bazuar në analizën e rrjedhës së energjisë elektrike e në veçanti periudhën e kontestuar të konsumatorit konstatohet se konsumatori për periudhën maj dhe qershor 2013 është faturuar vetëm me shpenzime në tarifën e ulët, ndërsa në periudhën korrik 2013 vetëm me shpenzime në tarifën e lartë, e që është në kundërshtim me shpenzimet e përgjithshme, pasi që prapë nga muaji 08/2013 energjia elektrike në njehsorin elektrik nr. 12466568 ka regjistruar në dy tarifa (të lartën dhe të ulët). Bazuar në këtë Bordi ka konstatuar se ky regjistrim i shpenzimit të konsumatorit nuk është real pasi që nga fillimi i periudhës 06/2008 deri në periudhën maj 2013 konsumatori është faturuar bazuar në shpenzimet e regjistruara në dy tarifat (tarifën e lartë dhe të ulët), përveç muajve 07/2011 deri më 09/2011 dhe muajt 10/2012 ku evidentohet se konsumatori është faturuar me shpenzime në një tarifë.

Bordi i ZRRE-së ka konstatuar se KEDS nuk ka respektuar Procedurën e Leximit dhe Faturimit të Konsumatorëve Tariforë si dhe Vendimin e tarifave të aprovuar nga Bordi i ZRRE-së, pasi që në rastin konkret konsumatori është dashtë të faturohet me dy tarifa për muajt kontestues.

Bordi i ZRRE-së ka vlerësuar se KEDS në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj, andaj si të tilla nuk paraqesin bazë të mjaftueshme për prishjen e këtij vendimi.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 16.05.2014 ka analizuar ankesën e KEDS dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. ZRRE/DMK_V_1114_04_14, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmimeve tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar